



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 290/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterëve në vende të palejuara, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 09.06.2014, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje dega në Prizren, me të cilën pretendohet se më datë 08.06.2014 në shkollën “Gjon Buzuku” në Prizren, më saktë qendra e votimit 2005a/05R, ka vërejtur se në afërsi më pak se 100 metra afër kësaj shkolle është i vendosur poster i kandidatit për deputet të Parlamentit të Republikës së Kosovës Irfan Fusha nga Partia Demokratike e Kosovës.

LVV pretendon se me këtë veprim Irfan Fusha nga PDK ka bërë shkelje të dispozitës së Nenit 7.1 pika a të Rregullës Zgjedhore të KQZ- së 11/2013, Kodit të Mirësjelljes për Subjektet politike, dhe Nenit 36.1 pikës b të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur 1 (një) fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se subjekti politik PDK dega në Prizren konkretisht kandidati për deputet të Parlamentit të Republikës së Kosovës Irfan Fusha ka vendosur posterët e tij në afërsi më pak se 100 metra nga qendra e votimit në shkollën “Gjon Buzuku”, janë të pabazuara pasi që nga fotografia e ofruar si dëshmi nuk mund të identifikohet se posterit në fjalë është i vendosur më afër se 100 metra siç pretendohet nga pala ankuese. Prandaj PZAP-i, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë

konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar, andaj në kuptim të Nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 290/2014 më datën 11.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*